




**KOMUNA E MALISHEVËS**



# **BULETINI**

---

**Nr. 108-Qershor 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>**



**Pamje nga Palestra e Sporteve “Habib Zogaj” në Malishevë**



## Përmbajtja

|                                                                                                                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Në kuadër të përvjetorit dëshmorit Ibrahim Mazreku u mbajt vrapimi memorial .....                                                                              | 3  |
| Më 16 Qershor, planifikohen dy përrurime .....                                                                                                                 | 6  |
| Nënskruhet marrëveshja për investime në vlerë prej 22 795 euro për katër SHMU .....                                                                            | 7  |
| U konstituua Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së .....                                                           | 8  |
| Zbulohet busti i dëshmorit Beqir Gashi .....                                                                                                                   | 8  |
| KO mban takim me rastin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve .....                                                                        | 9  |
| KK vendosi për çmimet tradicionale që ndahen për nder të 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve .....                                          | 10 |
| U përrua Palestra e Sporteve "Habib Zogaj" në Malishevë.....                                                                                                   |    |
| Malisheva shënoi 13 vjetorin e çlirimit.....                                                                                                                   | 11 |
| Drejtori Hoti, vizitoi të prekurit nga ethet hemorragjike.....                                                                                                 | 16 |
| Kryeshefi ekzekutiv i Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë, premtion dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin e stallave në Komunën e Malishevës ..... | 16 |
| Në "The European Times", do të jetë e prezantuar edhe Komuna e Malishevës .....                                                                                | 17 |
| Njësia e ujësjellësit së shpejti me objekt të ri.....                                                                                                          | 18 |
| Nga takimi i kryetarit me palët .....                                                                                                                          | 19 |
| Prezantohen të arriturat, diskutohet për projektet e mundshme.....                                                                                             | 19 |
| U prezantua vizionimi për zhvillimin e Malishevës.....                                                                                                         | 20 |
| MAPL përkrahë Malishevën në dy projekte.....                                                                                                                   | 21 |

## Në kuadër të përvjetorit dëshmorit Ibrahim Mazreku u mbajt vrapimi memorial

### Malishevë, 1 qershor



Organizuar nga klubi i atletikës “Malisheva”, mbështetur nga Federata e Atletikës e Kosovës dhe Komuna e Malishevës, u mbajt vrapimi memorial “Ibrahim Mazreku”, ku morën pjesë atletë nga të gjitha trojet shqiptare. Ky vrapim, është mbajtur në kuadër të shënimit të 13 vjetorit të rënies së dëshmorit të kombit Ibrahim Mazreku.

Duke e përshëndetur këtë aktivitet të madh sportiv në Malishevë, e ku morën pjesë atletë dhe atlete nga të

gjitha trojet shqiptare, Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, tha mes tjerash: “Jam i nderuar që marrë pjesë në hapjen e këtij aktiviteti sportiv i cili është i rëndësishëm për ne, në rend të parë për shkak të pjesëmarrjes gjithëkombëtare, por edhe për frymën garuese të këtij aktiviteti. Ky aktivitet sportiv ndërkaq bëhet edhe më i rëndësishëm kur e dimë që organizohet në nderim të dëshmorit Ibrahim Mazreku dhe dëshmorëve të tjerë, të cilët kanë rënë në fillim të qershorit 1999, pak ditë para se bisha serbe të dorëzohej dhe të largohej e mundur dhe e turpëruar nga lufta heroike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe përkrahjes së fuqishme që i vinte nga bota demokratike. Edhe sot, në këtë aktivitet sportiv ne do të kujtojmë Ibrahimin dhe të gjithë dëshmorët tjerë, të cilët u flijuan që ne të jetojmë të lirë, që qytetarët e Kosovës të jetojnë të lirë, që sportistët e saj të frymojnë lirshëm dhe t’i zhvillojnë aktivitetet e tyre lirisht dhe të pa penguar. Ju pjesëmarrës të nderuar të këtij vrapimi, sigurisht jeni të njoftuar tashmë se edhe vetë Ibrahim ishte një sportist i shkëlqyeshëm dhe atdhetar i devotshëm i cili ka rënë në altar in e lirisë ashtu siç bien vetëm trimat dhe ata që flijohen për atdhe. Të nderuar pjesëmarrës, jemi të sigurt se viteve të tjera, kushtet për organizmin e aktiviteteve tuaja do të jenë shumë më të mira, pasi komuna e Malishevës po bënë përpjekje për krijimin e një infrastrukture, e cila do të jetë në shërbim të sportit duke përfshirë këtu Pallatin e Kulturës, Stadiumin e Futbollit dhe projekte të tjera, të cilat do të jenë në shërbim të rinisë së mrekullueshme të kësaj komune”.

Ndërsa, kryetari i Federatës së Atletikës së Kosovës (FAK), z. Halil Sylejmani, e bëri hapjen solemne të këtij vrapimi. Duke folur për këtë, z. Sylejmani, tha se “kjo garë e sotme, i nderon të gjithë ata që luftuan



për vendin tonë. Federata e Atletikës e Kosovës, i është mirënjohëse edhe Komunës së Malishevës dhe klubit të atletikës nga ky qytet, për këtë organizim madhështor”.

Në emër të familjes së dëshmorit Ibrahim Mazrekut, të pranishmit i ka përshëndetur vëllai i tij Rexhep Mazreku.

Vrapimi është mbajtur në tetë kategori, ndërsa gara më interesante ishte ajo në kategorinë e juniorëve në tre mijë metra dhe atë të seniorëve në pesë mijë metra. Në kategorinë e juniorëve për meshkuj, vendin e parë e zuri atleti Florian Begaj nga klubi i atletikës “Malisheva”, ndërsa tek femrat Arbenita Oraça nga klubi i atletikës “Llapi”. Ndërsa në kategorinë e seniorëve për meshkuj, vendin e parë e zuri Genc Luxha nga klubi i atletikës “Tirana” nga Tirana, ndërsa për femra Brikenda Bakraqi nga klubi “Besa” e Pejës.

#### **Pioniere (F) 2000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Klubi Vendi

1 Laura Hyseni Trepça 89 Mitrovicë

2 Donika Veseli Llapi Podujevë

3 Shkurte Shala Llapi Podujevë

#### **Pionier (M) 2000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Klubi Vendi

1 Çlirim Hyseni Trepça 89 Mitrovicë

2 Lorik Haxhiu Trepça 89 Mitrovicë

3 Leotrim Haliti Besa Pejë

#### **Juniore (F) 3000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Klubi Vendi

1 Arbenita Oraca Llapi Podujevë

2 Ardita Cakaj Llapi Podujevë

3 Serafina Ramaj Besa Pejë

#### **Junior (M) 3000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Klubi Vendi



1 Florian Begaj Malisheva Malishevë

2 Ron Krasniqi Besa Pejë

3 Arber Selmani Llapi Podujevë

**Seniore (F) 5000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Klubi Vendi

1 Brikenda Bakraqi Besa Pejë

2 Antigona Shala Llapi Podujevë

3 Ganimete Ceroviku Trepça Mitrovicë

**Senior (M) 5000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Klubi Vendi

1 Genci Luxha Tirana Tiranë

2 Luan Sejdiu Prishtina Prishtinë

3 Avdyl Rusmeti Prishtina Prishtinë

**Veteran (M) 3000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Klubi Vendi

1 Skender Selmani Gjilani Gjilan

2 Zymer Alaj Juniku Junik

3 Isak Kadriaj Juniku Junik

**Nxënëset (F) 1000m**

Pl. Emri dhe mbiemri Shkolla

1 Arbenita Sertolli Ismail Qemaili

2 Shkurte Zogaj Ismail Qemaili

3 Ardita Berisha Habib Berisha

**Nxënësit (M) 1000m**



Pl. Emri dhe mbiemri Shkolla

1 Elbison Kafexholli Ismail Qemaili

2 Ajet Buzhala Naim Frashëri

3 Gjafer Krasniqi Ibrahim Mazreku

## Më 16 Qershor, planifikohen dy përurime

### **Malishevë, 4 qershor**

Me rastin e shënimit të 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, planifikohen të përurohen Salla e Sporteve dhe objekti i Komunës, kështu ka njoftuar sot, Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve.

Në këtë mbledhje, Kryetari Kilaj, ka kërkuar angazhim nga ana e drejtorive përkatëse dhe rritje të nivelit të përgjegjësisë, gjatë organizimit dhe festimi të 16 Qershorit, duke përfshi edhe dekorimin e qytetit.

Drejtori për Arsim dhe Edukim, z.Isuf Morina, ka njoftuar për përgatitjet për mbajtjen e testit të maturës shtetërore, e cila do të mbahet këtë të shtunë, si dhe për përfundimin e vitit shkollor, për klasat 10, 11 dhe 12 të nivelit të mesëm.

Ndërsa drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z.Skënder Hoti, njoftoi për situatën epidemiologjike, ku sipas tij “megjithë rastet e shumta të thumbimit nga rriqrat, situata është nën kontroll të plotë, si dhe është duke vazhduar spërkatja selektive e zonave endemike, përfshi edhe ditët e vikendit”.

*Në vazhden e projektit (për investime)mes shkollave të Komunës së Malishevës dhe Bankës Botërore*

## Nënshkruhet marrëveshja për investime në vlerë prej 22 795 euro për katër SHMU

### Malishevë, 5 qershor

Në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Malishevës, sot është nënshkruar marrëveshja për investime në katër shkolla të mesme të ulëta, midis drejtorëve të këtyre shkollave dhe bashkëpunëtorit profesional për arsimin në Kosovë nga Banka Botërore, z. Berat Thaçi.



Përfitues të këtij projekti, i cili ka filluar që nga viti 2010, janë 13 shkolla të Komunës së Malishevës, ndërsa sot, kanë nënshkruar marrëveshje drejtoresha e SHMU “Hasan Prishtina”- Tërpezë, znj. Rajmonda Krasniqi, mandej drejtorët e shkollave, “Habib Berisha”- Gurbardh, z. Sabit Berisha, “Ganimete Terbeshi”- Astrazup, z. Shemi Morina dhe “Afrim Krasniqi”- Bardh, z. Faik Krasniqi.

Në marrëveshjet e nënshkruara sot, kuptohet se të katër shkollat kanë përfutur mjete konkretizuese për lëndë shkencore dhe shoqërore, kabinete informatike, me mjete përcjellëse (përfshirë tavolina, karrige, llaptop), videoprojektor, lektura shkollore. I tërë ky projekt, kap shumën prej 22. 795 euro.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z. Isuf Morina, ka falënderuar Bankën Botërore e në veçanti z. Berat Thaçi për një bashkëpunim të shkëlqyer me Komunën e Malishevës. “Ky është një projekt që ka të bëjë me zhvillimin e arsimit në Malishevë, e që përfutues të tij janë gjithsej 13 shkolla të komunës, përfshirë edhe këto të katërtat, me të cilat u nënshkruan sot marrëveshjet, ndërsa ne si drejtori u jemi mirënjohës dhe falënderues Bankës Botërore dhe përfaqësuesit të saj z. Berat Thaçi, për bashkëpunimin e treguar me ne”, kështu u shpreh drejtori Morina. Falënderime për këto investime kanë shprehur edhe drejtorët e këtyre katër shkollave.

Vlen të përmendet se shkollat tjera, të cilat kanë përfutur deri më tani nga projekti i Bankës Botërore janë: “Dëshmorët e Fshatit”- Bubavec, “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”- Llozicë, “Afrim Buçaj”- Lladrovc, “Lasgush Poradeci”- Kijevë (Shkolla e Mesme Profesionale, “Bajram Curri”- Drenovc, “Ismet Jashari-Kumanova”- Temeqinë, “Rifat Berisha”- Berishë, “Tafil Kelmendi”- Balincë dhe “Vesël Pagarusha”- Pagarushë. Ndërsa shuma e përgjithshme e investimeve në këto 13 shkolla, është 84.315 euro.



## **U konstituua Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së**

### **Malishevë, 5 qershor**



Sot është mbajtur mbledhja e parë konstitutive e Komitetit për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së, e që fillimisht u zgjedh kryesuesi i këtij komiteti, këshilltari komunal Asllan Kastrati.

Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës së UÇK-së, përbëhet prej pesë anëtarëve, Asllan Kastrati (PDK)-kryesues, Adem Berisha (PDK), Filloretë Bytyçi (LDK), Bajrush Hoti (LDK) dhe Fatos Kryeziu (AAK).

Në mbledhjen e parë konstituive, anëtarët e këtij komiteti u zotuan që brenda mundësive dhe kompetencave të komitetit, për angazhim maksimal. “Ne do të angazhohemi maksimalisht për problemet me të cilat përballen anëtarët e kësaj kategorie të shoqërisë, sa të ndjeshme, aq edhe krenare”. Takimin e sotëm e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z. Ragip Begaj.

*Në kuadër të ditës së shkollës*

## **Zbulohet busti i dëshmorit Beqir Gashi**

### **Malishevë/Mleqan, 6 qershor**

Në Mleqan të Malishevës, në kuadër të ditës së shkollës, e cila mban emrin e dëshmorit Beqir Gashi, është zbuluar busti i tij. Me këtë rast janë përkujtuar dëshmorët e këtij fshati Beqir Gashi dhe Hazir Kryeziu. Bustin e dëshmorit e zbuluan Isni Kilaj- Kryetar i Komunës së Malishevës, Mehmet Jashari-komandant i FSK, Ymer Gashi-vëlla i dëshmorit Beqir Gashi, Habib Kryeziu-vëlla i dëshmorit Hazir Kryeziu, Xhavit Jashari, nga Shoqatat e Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe Sinan Kryeziu-kryetar i fshatit Mleqan.





Fjalë rasti, mbajti drejtori i shkollës z. Alush Kryeziu, i cili në mes tjerash, duke adresuar merita për dëshmorët e kombit, tha se “ falënderimet për këtë kremte u takojnë atyre që kthyen buzëqeshjen në fytyrën e fëmijëve tanë”.

Më pas Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, pasi ka përshëndetur familjet e dëshmorëve Beqir Gashi e Hazir Kryeziu, por edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit, tha se, “ kënga dhe pushka e tyre janë frymëzuese për ne. Ata që i thurën këngë lirisë, u flijuan edhe vet për liri, ndërsa sot emrat e tyre gdhenden në emra shkollash, rrugësh, parqesh, për t’u kujtuar me nder dhe krenari”.



Në emër të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, foli Xhavit Jashari, e që sipas tij “sot kemi të drejtë të ndihemi krenar, sepse kudo po vendosim shenjtat e historisë së ndritshme kombëtare”.

Ibrahim Gashi, vëlla i dëshmorit Beqir Gashi, përshëndeti të pranishmit në emër të familjeve të dëshmorëve.

Më pas u dha një program i pasur kulturo-artistik.

## KO mban takim me rastin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve

### Malishevë, 7 qershor

Këshilli Organizativ (KO), ka mbajtur sot takim, me rastin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Ky këshill është formuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, ndërsa është udhëhequr nga Kryetari Isni Kilaj.

Në këtë takim u diskutua çështja e agjendës dhe e aktivitete që do ta shënojnë këtë ditë.



KO, përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike, përfaqësuesit e tri shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, shoqëria civile, Policia e Kosovës.

## **KK vendosi për çmimet tradicionale që ndahen për nder të 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve**

### **Malishevë, 13 qershor**



Asambleja Komunale e Malishevës, në mbledhjen e saj të njëzetet (28) të radhës, me shumicë të votave, ka miratuar propozimet e Këshillit Organizativ për shënimin 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve, për emrat apo personave që këtë vit do t'iu jepen çmimet tradicionale për Trimëri dhe Heroizëm "Imer Krasniqi", për kontribut në shkollën shqipe "Hamdi Berisha" dhe për kontribut në shëndetësi "Shpëtim Robaj".

Në emër të Këshillit Organizativ (KO), para këshilltarëve komunal, propozimet i ka paraqitur Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, si dhe ka lexuar biografitë e të propozuarve nga ana e shoqatave të dala nga lufta, përkatësisht Drejtoria e Arsimit dhe ajo e Shëndetësisë.

Me vendim të KK të Malishevës, këtë vit çmimet do t'iu jepen:

Për Trimëri dhe Heroizëm "Imer Krasniqi", Xhemajli Zogaj, nga Bellanica dhe Shqipe Krasniqi, nga Tërpeza e Ulët;

Për kontribut në shkollën Shqipe "Hamdi Berisha", Ismet Gegaj nga Lladroci dhe Hajdin Bacaliu nga Kijeva;

Për kontribut në shëndetësi "Shpëtim Robaj", Ymer Aliun dhe Rexhep Gara nga Prishtina.

Këta emra janë votuar me shumicë të votave, ndërsa në votim nga kanë marrë pjesë këshilltarët komunal nga radhët e opozitës (LDK, AAK dhe LDD).

## U përrua Palestra e Sporteve në Malishevë

### Malishevë, 14 qershor

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës, sot, solemnisht është përruar edhe Palestra e Sporteve “Habib



Zogaj” në Malishevë. Shiritin e përrimit e prenë Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, Ministri i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport (MKRS), z.Memli Krasniqi dhe z.Bahti Zogaj, prindi i dëshmorit Habib Zogaj, emrin e të cilit e mban Palestra e Sporteve në Malishevë.

Fillimisht, kryetari Kilaj, ka pritur në zyrën e tij, ministrin Krasniqi, të cilin e ka njoftuar me investimet e komunës në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, siç është Shtëpia e kulturës, prej sot edhe Palestra e sporteve, pastaj fusha e futbollit të madh, në ndërtim e sipër, si dhe për nevojat dhe kapacitetet që ka Malisheva. “Shfrytëzoj rastin që t’iu falënderoj për investimin e ministrisë suaj, e cila ka financuar në tërësi ndërtimin e Palestrës së sporteve”, tha mes tjerash kryetari Kilaj, duke e falënderuar ministrin Krasniqi.

Ndërsa ministri Krasniqi, pasi falënderoi për pritjen, përgëzoi komunën dhe kryetarin Kilaj, për përkushtimin e madh në krijimin e infrastrukturës në fushat e sportit, kulturës dhe rinisë, tha se “ndërtimi i kësaj palestere ka kushtuar rreth 2.2 milion euro dhe është investimi më i madh i kësaj



ministrie, deri më tani, por Malisheva meriton shumë më shumë se kaq, pasi ka bërë dhe ka dhënë shumë për Kosovën”, tha ministri Krasniqi. Po ashtu ministri i MKRS-ës, premtoi se do angazhohet edhe për përkrahje më të madhe, për Malishevën dhe komunat tjera.

“Sot po përurojmë një objekt të përmasave jo vetëm të Kosovës, por edhe më gjerë, objekt i cili e kompletton Malishevën si një qytet, të cilin e kemi ëndërruar, jo vetëm gjenerata jonë, por edhe gjeneratat e kaluara. Është sakrifica e dëshmorëve tanë, që ne sot i përkujtojmë, na mundësuan që ne sot të ndërtojmë dhe përurojmë objekte si kjo dhe të tjerat që i kemi përruar me herët. Unë e falënderoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi, për këtë dhuratë dhe ministrin Krasniqi, për këtë përkrahje”, tha mes tjerash kryetari Kilaj, me rastin e përrimit të Palestrës së sporteve “Habib Zogaj”.

“Me padurim e kam pritur këtë ditë, që për të rinjtë e Malishevës, është një shtëpi e dytë. Urime dhe e gëzofshi. Do të jetë një institucion i rëndësishëm, prej ku do të dalin talent, që do të jenë krenaria, jo vetëm e Malishevës, por edhe e Kosovës. Ju konfirmoj edhe për mbështetje të mëtutjeshme në fushën e sportit, kulturës, rinisë dhe trashëgimisë kulturore. Ju i keni dhënë shumë Kosovës, në rrugën e lirisë dhe shtetndërtimit, andaj edhe meritoni një vëmendje të veçantë nga institucionet dhe shoqëria në përgjithësi. Ky investim prej 2.2 milion euro, është një obligim i Qeverisë së vendit ndaj Malishevës, që i dha kaq shumë vendit tonë. MKRS do të jetë gjithnjë në përkrahje dhe mbështetje të projekteve për Malishevën. Në vigjilje të shënimit të Ditës së Çlirimit të Malishevës, shfrytëzoj rastin t’i uroj të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës”, tha ministri Krasniqi, në fjalën e tij, me rastin e përrimit të Palestrës së sporteve “Habib Zogaj”.

Kryetari Kilaj dhe ministri Krasniqi, ishin të parët që gjuajtën në kosh, në lojën e parë miqësore në basketboll në këtë palestër. Kilaj e Krasniqi, më pas vizituan edhe fushën e futbollit, Shtëpinë e kulturës dhe Qendrën e Kompetencës në Malishevë.



## Malisheva shënoi 13 vjetorin e çlirimit

### Malishevë, 16 qershor



Komuna e Malishevës, sot ka shënuar 16 Qershorin-Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Me këtë rast janë zhvilluar aktivitete të ndryshme, ku pas pritjes tradicionale për qytetarë, nga ana e Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, në zyrën e tij, janë bërë nderime para shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari në Malishevë, pastaj homazhe në varrezat e dëshmorëve në Malishevë e Kleçkë, si dhe përrurimi i Qendrës së Bizneseve në Malishevë.

Në ora 12:00, është mbajtur manifestimi qendror, ku janë ndarë edhe çmimet tradicionale, për Trimëri dhe Heroizëm “Imer Krasniqi”, për ish luftëtarët e UÇK-së, Shqipe Krasniqi dhe Xhemajli Zogaj, pastaj çmimi për kontribut në shkollën shqipe “Hamdi Berisha”, për veteranët e arsimit në Malishevë, për Ismet Gegajn dhe Hajdin Bacaliun dhe çmimi për kontribut në shëndetësi “Shpëtim Robaj”, për Ass.dr.sc. Ymer Aliun dhe Rexhep Garën.



Po ashtu Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, ka dhënë mirënjohje për kontribut në luftën e UÇK-së, në territorin e Malishevës, për Sabedin Berisha, Qazim Dahsyla, Drita Vula dhe Daver Haskuka, si dhe mirënjohje për kontributin e dhënë në pajtimin e gjaqeve, për Xhevat Kryeziu, Januz Mazreku, Fetah Bekolli, Cen Desku dhe Ali Gashi.

Në manifestimin qendror, ku përveç strukturave më të larta lokale, morën pjesë edhe zv/ministri i MPMS-ës, z.Fatmir Shurdhaj, deputetët e



Kuvendit të Kosovës, z.Halit Krasniqi dhe Hasime Mazreku-Krasniqi dhe qytetar të shumë, veteran të luftës dhe familje të dëshmorëve, fjalimin kryesor e mbajti, kryesuesi i Asamblesë Komunale, z.Ragip Begaj, ndërsa në emër të shqotave të dala nga lufta e UÇK-së, foli kryetari degës së OVL të UÇK-ës, në Malishevë, z.Enver Hoti.

Ditës së sotme, i kanë paraprirë, një varg aktiviteteve kulturore dhe sportive, si dhe përrurime, si Palestra e Sporteve, ndërsa aktivitetet do të përfundojnë me një koncert të madh, që mbahet në qendër të qytetit dhe me ndezjen e fishekzjarrëve.



Në vazhdim fjalimi kryesuesit të KK të Malishevës, z.Ragip Begaj:

Komuna e Malishevës

Kryesuesi i KK-së Ragip Begaj

Malishevë, datë 16 qershor 2012

I nderuari kryetar i komunës z. Isni Kilaj, të nderuara familje të dëshmorëve, invalid e veteran, të nderuar anëtarë të kuvendit, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, përfaqësues ndërkombëtarë, përfaqësues të subjekteve politike dhe jo politike, të Policisë së Kosovës, të FSK-së dhe të gjithë ju pjesëmarrës të kësaj kremte madhështore;

Jemi sot prapë bashkë që të kremtojmë Ditën e Çlirimit e cila në komunën e Malishevës përkon edhe me Ditën e Dëshmorëve të kësaj komune.

Jam i lumtur dhe i nderuar që edhe në këtë përvjetor para jush po shpalosim të arriturat që janë shënuar dhe të cilat jo vetëm që përmirësojnë jetën e qytetarëve tanë por edhe paraqesin bazë të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të komunës së Malishevës.

Në kuadër të kësaj date të shënuar, sivjet kemi bërë përrurimin e Pallatit të Sporteve, një projekt kapital dhe shumë i rëndësishëm i cili i ka munguar komunës sonë.

Jemi të sigurt se ky objekt madhështorë që për ne dikur ishte veç një ëndërr, do ti krijoj kushte shumë më të mira rinisë sonë të mrekullueshme që të merret me aktivitete sportive në mënyrë që me sukses të prezantoj sportin e komunës sonë në vend dhe botë.





Në Ditën e Çlirimit po ashtu po përurojmë edhe Qendrën e Biznesit një projekt ky i përbashkët me Agjensionin Evropian, projekt me miqtë tanë të cilët dje na ndihmuan të fitojmë lirinë kurse sot po na ndihmojnë në krijimin e kushteve më të mira për qytetarët tanë.

Krahas këtyre dy projekteve të mëdha ndërkaq në Malishevë në mes të dy përvjetorëve janë përfunduar apo janë në përfundim e sipër edhe projekte të tjera si shkolla, ujësjellës, kanalizime dhe projekte të tjera të cilat ndikojnë në përmirësimin e jetës sonë.

Të nderuar pjesëmarrës;

Kjo ditë tek ne shënohet falë sakrificave të mëdha dhe gjakut të derdhur të dëshmorëve tanë. Në këtë ditë të shënuar ne përkujtojmë me respekt gjakun e derdhur të komandantit Adem Jashari dhe familjes Legjendare Jashari, kujtojmë mijëra dëshmorët e Kosovës, kujtojmë gjakun e derdhur të 74 dëshmorëve të Malishevës, gjakun e derdhur të qindra martirëve të kësaj komune që u bënë gurëthemeli i lirisë sonë por kujtojmë me respekt dhe falënderojmë përjetësisht edhe ndihmën Amerikës dhe shteteve të Evropës dhe botës demokratike e cila u ngrit si kurrë më parë në mbrojtje të civilizimit, në mbrojtje të vlerave demokratike të cilat po shkeleshin nga Serbia e diktatorit Millosheviq.

Edhe sot, ne kujtojmë qindra beteja të zhvilluara për liri në këto troje në të cilat mbrohej nderi i grave dhe fëmijëve por edhe nderi i shqiptarisë i ruajtur brez pas brezi.

Të nderuar pjesëmarrës, të nderuar qytetarë të Malishevës;

Kujtimi për qëndresën mijëra vjeçare të shqiptarëve kudo në hapësirën shqiptare për të mbrojtur nderin dhe civilizimin, kujtimi për bashkëluftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës rënë nëpër istikame, kujtimi për qindra e mijëra martir të vrarë në pragun e shtëpisë, kujtimi për të zhdukurit dhe të plagosurit na shtyjnë që ne të zgjedhurit e këtij populli, të punojmë me krejt forcën që gjeneratave që sot e gëzojnë lirinë, tu krijojmë kushte më të mira për jetë.

Prandaj, edhe sot, në këtë ditë të shënuar për Malishevën zotohemi se do të punojmë me tërë dijen dhe forcën në realizimin e idealeve tona kombëtare sikur edhe në krijimin e një jete më të mire për të gjithë...

Jemi krenarë që i takojmë Malishevës e cila dha shumë për lirinë e atdheut dhe ishte e pa mposhtur në të gjitha kohërat...

GËZUAR DITËN E ÇLIRIMIT DHE DITËN E DËSHMORËVE,

Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për liri...



## **Drejtori Hoti, vizitoi të prekurit nga ethet hemorragjike**

### **Malishevë, 19 qershor**

Drejtori për shëndetësi, në Komunën e Malishevës, z. Skënder Hoti, ka vizituar të prekurit nga ethet hemorragjike, që janë të shtrirë në Klinikën Infektive të QKUK-së, në Prishtinë, ku është njoftuar drejtpërdrejt me gjendjen shëndetësore të tyre dhe ka konfirmuar se gjendja e tyre aktualisht është jashtë rrezikut për jetë.

“Në takimin me dr.Sali Ahmetin dhe Gëzim Morinën, në Klinikën Infektive, jam njoftuar se një person është i konfirmuar me ethe hemorragjike, por gjendja e tij është jashtë rrezikut për jetë, ndërsa një person tjetër, është në pritje të analizave përfundimtare”, ka deklaruar drejtori Hoti, pas vizitës së dy personave të shtrirë në klinikën infektive.

“Deri më sot, kemi mbi 900 raste të thumbuar nga rriqrat, ku katër prej tyre kanë rezultuar të infektuar nga ethet hemorragjike, ndërsa një rast ka përfunduar me vdekje”, tha Hoti. Sipas drejtorit Hoti, “Ka përfunduar fushata e vetëdijesimit të qytetarëve dhe e spërkatjes selektive të 39 zonave endemike, ndërsa tani do fillohet me fazën e dytë të spërkatjes”.

“Deklarimi i mbrëmshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, se gjoja, janë ndarë vitin e kaluar 20 mijë Euro, për fushatën e spërkatjes së zonave endemike në Malishevë, nuk qëndron, dhe me këtë rast shprehi keqardhje për këtë dezinformim të opinionit, me të pavërteta. Po ashtu, nuk është e vërtetë që Ministria e Shëndetësisë, nuk ka mjete për luftimin e etheve hemorragjike, por konsiderojmë se janë neglizhent në këtë drejtim, për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të Komunës së Malishevës”, deklaroi drejtori Hoti, në reagimin e tij, ndaj deklarimit të zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë, se vitin e kaluar janë ndarë 20 mijë euro për spërkatjen e zonave endemike kundër rriqrave.

## **Kryeshefi ekzekutiv i Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë, premton dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin e stallave në Komunën e Malishevës**

### **Malishevë, 19 qershor**

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Skënder Hoti, kanë pritur në takim, një delegacion nga Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në nivel shteti, konkretisht kryeshefin e këtij agjencioni, z. Valdet Gjinovci dhe drejtorin e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, z. Bafti Murati.

Në këtë takim, kryeshefi i AUV, z. Gjinovci ka premtuar se në Komunën e Malishevës, do të bëhet dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi i stallave dhe kafshëve me preparatin repelente.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Kilaj, ka falënderuar delegacionin për këtë vizitë, dhe ka njoftuar me gjendjen momentale në komunë, në lidhje me ethet hemorragjike.



## Në “The European Times”, do të jetë e prezantuar edhe Komuna e Malishevës

### Malishevë, 20 qershor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim drejtorin regional të gazetës “The European Times”, z. Viktor Gjorgjieski dhe bashkëpunëtorin e tij z. Seth Ymich. Qëllimi i këtij takimi ishte theksimi dhe identifikimi i sektorëve të ndryshëm në fushën e zhvillimit ekonomik, por edhe në lëmi të tjera, të cilat i posedon komuna, si dhe mundësitë e investimeve në këta sektor.

“Përmes gazetës tonë, ne duam të tregojmë potencialin për investime të ndryshme, në sektor të ndryshëm, dhe

për të informuar investitorët, me kushtet që i ofron Komuna e Malishevës”, kështu tha midisi tjerash z. Gjorgjieski, gjatë takimit me Kryetarin e Komunës, z. Kilaj. Më pas Gjorgjieski, shtoi se gazeta në fjalë së bashku me zyrtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë duke punuar për identifikimin e mundësive të investimeve nga investitor ndërkombëtar, p.sh. në shëndetësi, arsim, energjetikë, tregti, industri, bujqësi, blegtori, turizëm, etj., por edhe të promovoj sukseset e arritura në zhvillimin ekonomik.

Në anën tjetër Kryetari Kilaj u pajtua, që në numrin e ardhshëm të gazetës “The European Times”, të jetë e përfshirë me profilin e saj, mundësitë e investimeve dhe shembuj të sukseseve, edhe Komuna e Malishevës, ndërsa më pas i informoj vizitorët se sektorë kryesor për investime në Komunën e Malishevës, është sektori i bujqësisë, mandej blegtoria, turizmi, por edhe ndërtimi i një parku biznesesh, në afërsi me autostradën, e cila kalon nëpër territorin e Komunës së Malishevës. Më pas z. Kilaj, ka përmendur edhe ujëvarat e Mirushës, shpellën e Panorcit, pishinën e Banjës, etj.

“Një gjë e garantoj për të gjithë investitorët, së bashkëpunimi im është i pakontestueshëm, ndërkohë premtoj edhe përshejtimin e rregullimit të procedurave administrative që ata duhet ndjekur, për realizimin e projekteve të tyre në Komunën e Malishevës, por edhe rregullimin e infrastrukturës së duhur”, kështu u shpreh Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, për “The European Times”, e cila sipas drejtorit regional të saj, u shpërndahet drejtpërsëdrejti rreth 410 mijë lexuesve europian, konkretisht drejtues profesional të bizneseve.

## Njësia e ujësjellësit së shpejti me objekt të ri

### Malishevë, 20 qershor



Njësia e “Hidroregjionit” në Malishevë, së shpejti do të bëhet me objekt të ri të shërbimeve administrative, duke krijuar kushte më të mira të punës, për zyrtarët e kësaj njësie, pasi sot është vënë gurëthemeli i objektit të ri. Ndërtimi i objektit është mundësuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Lopatën e parë me beton, në themelet e objektit, e vuri nënkryetari i Komunës së Malishevës, z. Rexhep Mazreku, i cili, pasi uroi për objektin, apeloj tek konsumatorët

“për shfrytëzim racional të ujit dhe kryerje të obligimeve ndaj kompanisë, me qëllim të furnizimit sa më të mirë me ujë për pije”.

“Objekti do të kushtoj rreth 74 mijë euro dhe financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ndërsa projekti, pritët të përfundoj në afat kohor prej tre muajve”, bëri të ditur Njazi Bytyçi, menaxher i njësisë së “Hidroregjionit” në Malishevë.



## Nga takimi i kryetarit me palët

### **Malishevë, 21 qershor**

Për dy orë të tëra (nga 10:00-12:00), Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur palët, nga të cilët është njoftuar për së afërmi me problemet dhe shqetësimet e tyre.

Shqetësimet e tyre ishin të natyrave të ndryshme, për të cilat në raste të caktuara, kanë marr ndihmën e kryetarit, qoftë në cilësinë e përkrahjes morale, por edhe për sugjerime të ndryshme se si ata duhet ndjekur procedura për të arritur në qëllimet e tyre.

Shumica e shqetësimeve të palëve ndërlidheshin me aspektin social.

*Nga takimi i parë publik me qytetarët për këtë vit*

## Prezantohen të arriturat, diskutohet për projektet e mundshme

### **Malishevë, 28 qershor,**



Në takimin e parë publik (për këtë vit), me qytetarët e Komunës së Malishevës, kryetari Isni Kilaj, ka përshëndetur të pranishmit në sallë, ndërsa më pas ka njoftuar me pikat e parapara për takimin publik e që kishin të bënin me realizimin e projekteve kapitale për vitin 2012, apo atyre në realizim, dhe pyetjet e të pranishmëve.

Sipas Kryetarit Kilaj, “projektet të cilat kanë përfunduar, ato që janë përfunduar dhe ato që janë në proces të realizimit janë si në vijim: palestra e sporteve (është bërë përfundim i saj me 16 qershor), qendra e biznesit (ndërtuar

bashkë me AZHR), ujësjellësi i Lladrovçit (së bashku me USAID-in), stadiumi i futbollit, kolektori i ujërave të zeza, shtrati i lumit Mirusha, shpella e Panorcit, asfaltimi i rrugëve në Bubavec, Kijevë dhe Balincë (filluar këto ditë), rrjete kanalizime në shumicën e fshatrave, presim tenderime për fshatra të tjera, shkolla fillore “Ilmi Hoti” në Carrallukë, do të filloj shkolla fillore në Vërmicë - faza e parë, kemi furnizuar me material ndërtimor katër familje, për ndërtim të shtëpive, të pastreha: Guncat, Senik, Drenovc,





Gurbardh, zgjerimi i rrugës në Malishevë, pjesa prej qendrës (700m), në drejtim të Banjës, mirëmbajtja e rrugëve verore, ndihmë për fermerët, ndërtimi i objektit të Qendrës për Punësim, ndërtimi i muzeut të qytetit (në procedurë e sipër), shkolla fillore në Banjë, e cila më 1 shtator do të jetë gati, spërkatja e terreneve, kundër rriqrave, zgjerimi i rrugës afër gjimnazit, hartimi i planit zhvillimor urbanistik për Komunën e Malishevës, së bashku me UN-HABITAT-it , etj”. Këto ishin disa nga projektet që kanë përfunduar, por edhe që janë në proces të përfundimit ose edhe në procedura tenderuese, bëri të ditur kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj.

Më pas të pranishmit, kanë parashtruar disa pyetje në lidhje me shqetësimet e tyre, kryesisht në lidhje me çështjen e energjetikës, përfshirë këtu shtyllat e vjetruara në disa vendbanime, kanalizime, e çështje të tjera të kësaj natyre, për ç’gjë kanë marrë përgjigje nga kryetari i Komunës.

## U prezantua vizionimi për zhvillimin e Malishevës

### Malishevë, 28 qershor

Sot në Malishevë, është bërë prezantimi i rezultateve të punëtorisë së vizionimit për Malishevën, në kuadër të programit për hartimin e planit zhvillimor komunal, projekt i cili mbështetet nga UN-HABITAT-i. Në këtë prezantim, morën pjesë, Kryetari i Malishevës, z. Isni Kilaj, zv/ministri i Ministrisë për Planifikim Hapësinorë, z. Shpëtim Rudi, përfaqësuesja e UN-HABITAT-it në Kosovë, znj. Krystyna Galezia dhe përfaqësues të organizatave dhe fondacioneve të ndryshme që veprojnë në Kosovë, por edhe qytetarë nga Komuna e Malishevës, përfshirë edhe përfaqësues të organizatave lokale joqeveritare.



Vizionimi për zhvillimin e Komunës së Malishevës, është raport i punëtorisë katërditore e grupit prej 25 planifikuesve me profesione të fushave të ndryshme dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ky vizion do të formojë bazën për Planin Zhvillimor të Komunës së Malishevës, për një periudhë afatmesme dhjetëvjeçare.



“Malisheva, në vitin 2004 ka pasur një plan zhvillimor, vetëm për Qendrën e Malishevës. Komuna jonë duhet të kenë një plan për zhvillim, pasi është me rëndësi jetike për komunën tonë.”, tha në fjalën e rastit, Kryetari i Komunës së Malishevës, Kilaj, duke folur për rëndësinë e këtij plani, përderisa falënderoi UN-HABITATIN, për ndihmën e dhënë në hartimin e këtij plani.

Ndërsa zv/ministri për Planifikim Hapësinorë, z.Shpëtim Rudi, në fjalën e tij të rastit tha se “ ky plan, është bazë e mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të Malishevës”.

Ndërsa Krystyna Galezia, falënderoi kryetarin dhe të gjithë planifikuesit e këtij plani për punën e bërë, Ajo më pas foli për punën e organizatës që ajo përfaqëson dhe ndihmën e UN-HABITAT-it për hartimin e planeve zhvillimore për komunat në Kosovë, ashtu si edhe në Malishevë. Ajo më pas foli edhe për resurset e Malishevës, për një zhvillim të përgjithshëm dhe të qëndrueshëm dhe uroi që ky vizion të shndërrohet në realitet.

Edhe drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm, z.Esat Paçarizi, foli për ecurinë e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal në përgjithësi, dhe për rezultatet e fazës së parë të hartimit të këtij plani, e që sipas tij “plani zhvillimor komunal (dokument bazë në zhvillimin e komunës ), është plan multisektorial, i cili përcakton synimet afatgjate të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor të Komunës . Ky Dokument do të përmbajë planet për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale. PZHK duhet të shërbej si udhërrëfyes dhe kontrollues i tërë procesit zhvillimor të komunës për një periudhë minimum 10 vjeçare”.

Ky vizionim, që ka të bëjë me planin zhvillimor të Komunës së Malishevës, sot u prezantua nga përfaqësues të katër grupeve, që kanë punuar në katër fusha.

Fushat e prezantuara kanë të bëjnë me:

1. Banimi dhe shërbimet publike;
2. Zhvillimi ekonomik;
3. Infrastruktura dhe lëvizshmëria;
4. Mjedisi dhe trashëgimia kulturore.

## **MAPL përkrahë Malishevën në dy projekte**

### **Malishevë, 29 qershor**

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), për realizimin e përbashkët të dy projekteve, që do të realizohen në dy fshatra të Komunës së Malishevës.



Kryetari Kilaj, ka bërë të ditur se vlera e projekteve, është 150 mijë euro, prej të cilave 80 mijë euro janë pjesë e komunës, ndërsa 70 mijë euro të MAPL-së. “Projektet, që janë planifikuar të realizohen me këto mjete, janë, ndërtimi i një pjese të kanalizimit për fshatin Drenovc dhe kanalizimi për fshatin Senik”, bëri të ditur kryetari Kilaj.

Realizimi i këtyre projekteve do të filloj, pas përfundimit të procedurave të tenderimit, ndërsa janë pjesë e investimeve në infrastrukturën e rrjeteve të kanalizimit dhe në të njëjtën kohë, janë pjesë e realizimit të premtimit të Kryetarit të Komunës, z. Isni Kilaj, që brenda vitit 2012, të përfundoj ndërtimi i rrjeteve të kanalizimit, për të gjitha fshatrat e Komunës së Malishevës.